




Opština Novo Brdo Komuna e Novobërdës - Municipality of Novo Brdo

Thirrje publike për ofertat për mbështetje financiare publike për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve në fushën e zhvillimit të turizmit

1. Komuna e Novobërdës fton të gjitha organizatat joqeveritare (OJQ) që janë të regjistruara dhe programi i punës i të cilave është i fokusuar në zhvillimin e potencialit turistik të komunës dhe rajonit, të aplikojnë për mbështetje financiare për realizimin e projekteve për promovim dhe zhvillim i potencialit turistik të komunës së Novobërdës.
2. Në përputhje me këtë Thirrje Publike, organizatat joqeveritare (OJQ) mund të aplikojnë me projekte/thirrje për aktivitetet e mëposhtme:
 - 1) Promovimi i produkteve turistike, destinacioneve turistike dhe zonave turistike të Novobërdës,
 - 2) Inkurajimi i përmirësimit të ofertës pritëse turistike dhe mikpritëse,
 - 3) Përmirësimi dhe zbatimi i hulumtimit statistikor,
 - 4) Projekt edukimi dhe trajnimi në turizëm,
 - 5) Promovimi i trashëgimisë kulturore.
3. Organizata joqeveritare (OJQ) mund të paraqesë vetëm një projekt të veçantë, i cili do të përfshijë zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në pikën 2 të kësaj Thirrjeje Publike.
4. Vlera totale e planifikuar e Thirrjes Publike është deri në 8,000 (tetë mijë) euro. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të jepet për çdo projekt individual është 1,000 (një mijë) euro, shuma maksimale për projektin është deri në 5,000 (pesë mijë) euro.
5. Afati për dorëzimin e projekt propozimeve është 15 ditë pune nga data e publikimit të Thirrjes Publike, gjegjësisht data e fillimit është 07.11.2022, dita e fundit për dorëzimin e Propozimeve është 25.11.2022.
6. Organizatat joqeveritare (OJQ) që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të Republikës së Kosovës, me seli në territorin e komunës së Novobërdës, të cilat janë të regjistruara jo më vonë se 30 shtator 2022, kanë e drejta për të aplikuar.



Opština Novo Brdo Komuna e Novobërdës - Municipality of Novo Brdo

Nëse aplikanti - organizatë joqeveritare (OJQ) ka qenë përfitues i mjeteve financiare nga Komuna e Novobërdës, është i obliguar të paraqesë dëshmi se i ka arsyetuar mjetet me paraqitjen e raportit financiar.

Para nënshkrimit të kontratës, organizatat joqeveritare (OJQ) duhet të ofrojnë dëshmi se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetim penal, si dhe dëshmi se OJQ-ja ka zgjidhur të gjitha çështjet e hapura në lidhje me pagesën e kontributeve të papaguara dhe taksat.

7. Propozimet dorëzohen vetëm në formularin e paraparë, i cili së bashku me udhëzimet për aplikantët mund të shkarkohet nga uebfaqja e komunës së Novobërdës - , dokumentacioni i plotë duhet të dorëzohet me postë ose personalisht, në adresën: Komuna e Novobërdës, s. Bostanë nn, 16000 Novobërdë.

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimi i aplikacioneve, kontraktimi, burimet, koha dhe mënyra e paraqitjes së ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari i zbatimit të thirrjeve janë paraqitur në mënyrë të detajuar në udhëzimet për aplikantët. Do të shqyrtohen vetëm propozimet që janë dorëzuar brenda afatit për dorëzimin e aplikacioneve dhe formularët që janë të rregulluar me Thirrjen Publike.

8. Të gjitha pyetjet në lidhje me ftesën publike mund t'i sqaroni vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar një e-mail në adresën: info.novoberde@rks-gov.net



Kryetari i komunës

Saša Milošević

Vendimi ti dorzohet:

- Kabinetit të kryetarit të komunës;
- Drejtoris për buxhet dhe financa;
- Drejtoris së administratës;
- Arhivit.